



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 267

NR. VENDIMI 2824

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

Nr. 9221/1565/548/356/289/267 Regj. Themeltar
Nr. 2824 Vendimi

Data e regjistrimit 11.05.2016
Datë 30.04.2021

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përberë nga

Gjyqtar: Julian HAXHIU

me asistencen e sekretares gjyqësore Klaudia ABAZAJ, sot më datë 30.04.2021, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile me Nr. 267 Regj. Themeltar, që u përket palëve:

PADITES: Shoqëria *** perfaqesuar nga administratori *** me adrese ***.

PALA E PADITUR: ***- Person fizik me adrese ***.

OBJEKTI: Konstatimin e përdorimit të paautorizuar të markës tregtare *** dhe *** , e regjistruar kjo e fundit nga mbajtësi i së drejtës pranë Drejtorisë së Përgjithsme të Patentave dhe Markave me numër regjistrimi kombëtar *** , nga shoqëria ***.

Ndalimin e përdorimit të markës tregtare *** në publikimin dhe reklamimin e shërbimeve nga palët e paditura.

Konstatimin e konkurrencës së pandershme nga palët e paditura.

Vendosjen e masës së sigurisë për sa më sipër për subjektin shkelës deri në marrjen e një vendimi të gjykatës.

BAZA LIGJORE: Neni 348 i K.Pr.Civile, Kodi Civil nenet 638 639, 202, 204 e vijues,

Ligji nr. 9947 date 07.07.2008 "Per pronesine industriale" neni 156 e ne vijim.

Gjykata konstatoi se ceshtja është në juridiksionin gjyqësor dhe në kompetencë të kësaj gjykate, degjoi konkluzionet përfundimtare të palëve, të cilat kërkuan:

Pala paditëse Shoqëria * kërkoj pranimin e padisë**

Pala e paditur * person fizik ne mungese**

dhe, pasi shqyrtoi provat dhe e bisedoi cështjen në tërësi,

VËREN:

Pala paditëse i është drejtuar gjykatës dhe ka kërkuar konstatimin e përdorimit të paautorizuar të markës tregtare * dhe ***, e regjistruar kjo e fundit nga mbajtësi i së drejtës pranë Drejtorisë së Përgjithsme të Patentave dhe Markave me numër regjistrimi kombëtar ***, nga shoqëria ***, ndalimin e përdorimit të markës tregtare **** në publikimin dhe reklamimin e shërbimeve nga palët e paditura dhe konstatimin e konkurrencës së pandershme nga palët e paditura**

Shoqëria *, është shoqëri e cila vepron në tregun shqiptar prej disa vitesh. Kjo shoqëri prej vitit 1996 ka përdorur logon *** fillimisht pranë *** prej edhe nga ka lindur ideja e kësaj marke tregtare dhe më pas prej vitit 2000 tek ***, duke pasur në përdorim dhe pronësi këtë markë prej *** vjetësh dhe duke u identifikuar me këtë markë tregtare. Këtë fakt e vërteton edhe reklamimi i emërtimit *** me emërtimin *** (sepse është bari i dytë që kemi me të njëjtin emër) në udhërrëfyesi praktik i kryeqytetit në libri Celsi i Tirana 2004 faqe 374 dhe dhe Tirana 2005 faqe 511. e Tirana 2006 faqe 605 dhe TIRANA 2008 faqe 723. Pala paditëse ka pretenduar se Shoqëria *** është pronar i markën tregtare **** me numër Regjistrimi Kombëtar *** për shërbime te klases 43 te klasifikimit të Nices : "Shërbime në fushën e restorantit, ushqime dhe pije; shërbime katering, shërbim bari, restorant, restorant me vetëshërbim, kafeteri; snack bar. Shoqëria *** gëzon të drejta që i jep ligji sipas nenin 156 pika 1,2. te ligjit nr.9947 dt. 07.07.2008 .**

Sipas palës paditëse *** me NIPT: *** ka përdorur dhe vazhdon të përdorë edhe sot e kësaj dite në mënyrë të pa autorizuar markën "****", në kushtet e konkurrencës së pandershme dhe në shkeljet e ligjit sipas nenin 156 pika 1,2. të Ligjit Nr.9947 dt. 07.07.2008 i ndryshuar. Pala paditëse ka pretenduar se *** fillimisht ka përdorur logon "****" duke e shndërruar më vonë në "****" pra e njëjta gjë nga "****" në "****" (në gjuhën Shqipe) duke krijuar idenë e rreme se kjo është e njëjta markë me markën e regjistruar "****" dhe shërbimi ofrohet nga i njëjti pronar dhe qëllimi i *** është për të përfituar nga emri i mirë që ka Bar "****" prej 24 vjetësh në treg duke shkelur të drejtat e kësaj markë sipas nenit 156 pika 1,2. të Ligjit nr.9947 dt. 07.07.2008 i ndryshuar.

Sip[as palës paditëse me anë Vendim Nr. *** date *** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: Detyrimin e të paditurit *** të ndaloj përdorimin e mëtejshëm të Markës Tregtare Bar "****" dhe "****" në zbatim të Ligjit Nr.9947 dt. 07.07.2008 i ndryshuar. (Ky vendim ka marrë formë të prera dhe ndodhet në dosjen e gjyqësorit). Gjithashtu sipas palës paditëse me anë të Vendimit Nr. *** prot.datë *** Bordi i Apelit i Drejtoria e Përgjithshme e Patentave e Markave ka vendosur refuzimin rregjistrimin e markës *** të aplikuar nga *** bazuar në nenin 143 të Ligjit Nr.9947 date 07/07/2008. Duke argumentuar se shkelje të drejtat e markës së mbrojtur ***. Me anë të Vendimit Nr. *** datë *** Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë për lënien në fuqi të Vendimit të Bordit të Apelit DPPI për refuzimin e markës "****" të aplikantit *** duke qenë në shkelje të drejtave të markës regjistruar ***.

Pala paditëse ka pretenduar se këto dy vendime vërtetojnë edhe njëherë se përdorimi i Logo "****" është në shkelje të drejtave të markës regjistruar "****" bazuar në nenin 143 të Ligjit Nr.9947 datë 07/07/2008 (I ndryshuar).

Sipas palës paditëse duke qenë se *** vazhdon përdorimin e logos "****" e" *** edhe sot e kësaj dite në shkelje të drejtës së pronsisë Industriale të markës regjistruar "****" dhe në kushtet e konkurrencës së pandershme duke përfituar nga tej zgjatja e proceseve gjyqësore duke na sjellë gjithashtu dëm ekonomik dhe moral, paditësi ka kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë që e paditura të mos vazhdojnë më tej përdorimin e emërimit tregtar "****".

Gjykata ka njoftuar rregullisht palën e paditur për këtë proces gjyqësor. Mirëpo pala e paditur pa asnjë shkak ligjor apo të arsyeshëm nuk është paraqitur në seancë gjyqësore. Për këtë arsye gjykata me kërkesë të palës paditëse, mbështetur në nenin 179 të Kodit të Procedurës Civile ka vendosur gjykimin në mungesë të palës së paditur.

Neni 44 i Kushtetutës, parashikon se:

“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.

Në nenin 348 të Kodit të procedurës Civile parashikohet se

Gjykimet në lidhje me patentat e të drejtat e tjera që rrjedhin nga pronësia industriale (Ndryshuar me ligjin nr.8812, datë 17.5.2001, neni 126)

Mosmarrëveshjet që rrjedhin nga patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjot tregtare, modelet dhe çdo e drejtë tjetër që rrjedh nga pronësia industriale, gjykohen nga seksioni i mosmarrëveshjeve tregtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod.

Në neni 143 të Ligjit Nr.9947 datë 07.07.2008 “Mbi pronësinë industriale”

Refuzimi për shkaqe relative

1. Marka nuk mund të mbrohet nëse përdorimi i saj bie në kundërshtim me të drejtat e mëparshme.

2. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo duhet të deklarohet e pavlefshme kur:

a) është e njëjtë me një markë të mëparshme dhe mallrat e shërbimet, për të cilat është aplikuar ose regjistruar ajo, janë identike me mallrat ose shërbimet, për të cilat është mbrojtur marka e mëparshme;

b) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, e cila mbrohet për mallra apo shërbime identike ose të ngjashme dhe kur, për shkak të njëjlojshmërisë ose të ngjashmërisë, ekziston mundësia e shkaktimit të konfuzionit te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e bashkëlidhjes me markën e mëparshme;

c) është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të mëparshme, edhe kur është për t’u regjistruar ose është regjistruar për mallra apo shërbime, që nuk janë të ngjashme me ato, për të cilat është regjistruar marka e mëparshme, kur marka e mëparshme ka një reputacion në Republikën e Shqipërisë dhe përdorimi ose regjistrimi i markës në fjalë, pa shkak të arsyeshëm, fiton prioritet të padrejtë ose dëmton natyrën dalluese apo emrin e mirë të markës së mëparshme.

3. Marka nuk mund të regjistrohet ose, nëse është regjistruar, ajo deklarohet e pavlefshme, nëse cenon të drejtat e mëparshme, të fituara, si:

a) të drejtën e emrit tregtar, me kusht që ky emër ose pjesa thelbësore e tij të jetë e njëjtë apo e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet, dhe që pronari i emrit tregtar të prodhojë apo të sigurojë përkatësisht mallra ose shërbime, të njëjta ose të ngjashme me ato të markës, që kërkohet të regjistrohet;

b) të drejtën e një personi, emri, mbiemri ose pamja e jashtme e të cilit është e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të regjistrohet;

c) të drejtat e pronësisë industriale, përfshirë emrat e varieteteve të mbrojtura, bimore dhe/ose shtazore dhe të treguesve gjeografikë;

ç) të drejtat e autorit të një vepre ose të një pjese të saj, me kusht që ajo të jetë e njëjtë ose e ngjashme me markën, që kërkohet të mbrohet.

4. Marka nuk mbrohet, nëse është e njëjtë ose e ngjashme me një markë të regjistruar, për mallra apo shërbime të njëjta ose të ngjashme dhe nëse vlefshmëria e saj ka mbaruar për shkak të mbarimit të afatit të mbrojtjes, për një periudhë gjashtëmujore nga mbarimi i këtij afati.

5. Markë e mëparshme, në kuptim të pikës 2 të këtij neni, vlerësohet:

a) marka, me një datë aplikimi për regjistrim më të hershme sesa data e aplikimit për regjistrim e një marke tjetër tregtare, duke pasur parasysh, kur është rasti, pretendimin për prioritet për atë markë, sipas nenit 147 të këtij ligji;

b) marka, që është regjistruar më parë, nëpërmjet një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë;

c) aplikimi për një markë, sipas përcaktimit të shkronjave "a" e "b" të kësaj pike, në varësi të regjistrimit të tyre;

ç) marka, e cila, në datën e aplikimit për regjistrim, ose në datën e prioritetit, në rastet kur pretendohet për prioritet, është e mirënjohur në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, të publiku i sektorit përkatës, si rezultat i përdorimit, përfaqësimit, publikimit ose reklamimit, në përputhje me parashikimet e DPPM-së dhe të autoriteteve ndërkombëtare.

Nga Çertifikata për regjistrim marke datë *** lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale rezulton se shoqëria Shoqëria *** është pronare e markës tregtare *** me afat 10 vjeçar me numër regjistrimi *** për mallrat e klasaës 43 të Klasifikimit të Nicës të klasifikimit ndërkombëtar të Nises, që përfshin fushën e Barit e restorantit .

Me në të Vendimit Nr. *** Prot. datë *** Bordi i Apelit i Drejtoria e Përgjithshme e Patentave e Markave ka refuzuar rregjistrimin e markës *** të aplikuar nga *** bazuar në nenin 143 të Ligjit Nr.9947 date 07/07/2008 (i ndryshuar).

Me anë të Vendimit Nr. * datë ***Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e padisë së paditësit dhe detyrimin e të paditurit ***të ndalojë përdorimin e mëtejshëm të markave tregtare ***” dhe ***.**

Me anë të Vendimit Nr. * datë ***Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë për lënien në fuqi të Vendimit të Bordit të Apelimit DPPI për refuzimin e markës “****” të aplikantit ***duke qenë në shkelje të drejtave të markës regjistruar ***.**

Me anë të Vendimit datë *Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë ka vendosur deklarimin fajtor të pandehurit *** për kryerjen e veprës penale të shkeljes të të drejtave të pronësisë industriale kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 149/a/2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me *** Lekë gjobë dhe deklarimin fajtor të pandehurit *** për kryerjen e veprës penale të shkeljes të të drejtave të pronësisë industriale kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 149/a/2 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me ***Lekë gjobë.**

Bazuar në nenin 30 të Kodit Penale të pandehurit *dhe të pandehurit ***u hiqet e drejta të ushtrojnë veprimtari tregtare duke përdorur markën tregtare “****” dhe ***.**

Gjykata riafirmon qëndrimin e ligjit se pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën ekskluzive të përdorimit të saj, në përputhje me të drejtat e parashikuara në Ligjin për Pronësinë Industriale. Gjithashtu pronari i markës së regjistruar gëzon të drejtën të ndalojë personat e tretë të përdorin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare, pa autorizimin e tij një shenjë që është e njëjtë ose e ngjashme me markën apo që për shkak të njëjlojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion te publiku, ku përfshihet mundësia e bashkëlidhjes së shenjës me markën tregtare.

Neni 143 i Ligjit për Pronësinë Industriale i garanton mbrojtje të fortë pronarit të një marke të mëparshme në të gjitha ato raste kur regjistrimi i një shenje nga të tretët mund të shkaktojë konfuzion te publiku përkatës. Jurisprudenca gjyqësore e Gjykatës Europiane e Drejtësisë në Luxemburg është tashmë e konsoliduar që mundësia për konfuzion provohet nëpërmjet një vlerësimi gjithëpërfshirës ku të mbahen parasysh të gjithë faktorët që kanë peshë për rastin konkret si ngjashmëria në mallra apo shërbime, ngjashmëria në marka/shenja, karakteri dallues dhe elementët dominues të markave/shenjave në diskutim, konsumatori përkatës.

Në Cështjen 251/95 Sabel vs Puma Gjykata Europiane e Drejtësisë është shprehur se

..... Shkalla e njohjes së markës në treg, shkalla e ngjashmërisë ndërmjet shenjës dhe markës dhe të mallrave të etiketuara prej tyre, ashtu si dhe mundësia për të bërë bashkim me markësn tregae te regjistruar, janë faktorët e huazuar nga preambula e direktivës prej gjykatave. Sa më të ngjashme të jenë mallrat ose shërbimet e etiketuara dhe sa më e dallueshme të jetë marka e mëparshme, aq më e madhe do të jetë dhe mundësia për ngatërrim. Gjatë përcaktimit të karakterit dallues të markës dhe përkatësisht edhe të vlerësimit sesa e dallueshme është ajo, konsiderohet e nevojshme kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kapacitetit të madh ose të vogël të markës për të dalluar mallrat ose shërbimet për të cilat ajo është regjistruar nën një sipërmarrje të caktuar dhe e dallimit me sipërmarrjet e tjera. Në kryerjen e vlerësimit duhet të merren parasysh të gjithë faktorët e lidhur me të, vecanërisht karakteristikat e trashëguara të markës, përfshirë faktin nëse ajo përmban apo jo ndonjë element përshkruar të mallrave apo të shërbimeve për të cilat është regjistruar....

Në Cështjen 251/95 *Sabel vs Puma* Gjykata Europiane e Drejtësisë vendosi se duhet të marrë parasysh konsumatori mesatar dhe se marka duhet konsideruar si e tërë. Është e qartë se në këtë perspektivë një markë shumë e dallueshme do të sillte më lehtë mundësinë për ngatërrim

Vlerësimi i mundësisë për konfuzion implikon një ndërveprim midis faktorëve domethënës ku një shkallë e ulët e ngjashmërive mes shenjave mund të kompensohet nga një shkallë e lartë ngjashmërie mes mallrave/shërbimeve dhe anasjelltas, apo pohimi tjetër se sa më e madhe të jetë fuqi tërheqëse e markës me reputacion, aq më shumë gjasa ka për konfuzion.

Gjatë hetimit gjyqësor gjykata është mbështetur në kriterin "kohë" në lidhje me këtë çështje gjyqësore. Domethënë për gjykatën është shumë e rëndësishme se cili subjekt tregtar ka regjistruar i pari markën tregtare *** pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Duke qenë se kemi të bëjmë me shoqëri tregtare që tregtojnë mallra të klasave afërsisht të njëjta sipas klasifikimit të Nices, gjykata merr në konsideratë kohën e regjistrimit për secilën nga markat tregtare objekt gjykimi. Nga Çertifikata e regjistrimit datë *** lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale rezulton se shoqëria Shoqëria *** është pronare e markës tregtare *** me numër regjistrimi *** datë *** për mallrat e klasës 43 të klasifikimit të Nicës : "Shërbime në fushën e restorantit, ushqime dhe pije; shërbime katering, shërbim bari, restorant, restorant me vetë-shërbim, kafeteri; snack bar dhe nga Çertifikata e regjistrimit datë *** lëshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Pronësisë Industriale rezulton se shoqëria Shoqëria *** është pronare e markës tregtare *** me numër regjistrimi *** datë *** për mallrat e të klasës 43 të klasifikimit të Nices: "Shërbime në fushën e restorantit, ushqime dhe pije; shërbime katering, shërbim bari, restorant, restorant me vetëshërbim, kafeteri; snack bar. Sa më sipër rezulton se pala paditëse ka regjistruar e para dhe sipas akteve normative mbi pronësinë industriale markën ***.

Ky është regjistrimi i parë dhe i vetëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme e Pronësisë Industriale në lidhje me markën tregtare * kryer nga shoqëria Shoqëria ***. Ndërsa pala e paditur nuk ka kryer asnjë regjistrim të markës së saj apo logos industriale në funksion të aktivitetit të saj tregtar.**

Për të bërë një analizë të saktë të ngjashmërisë ndërmjet markës së kundërshtuar dhe asaj të kundërshtuesit, duhet të merret në konsideratë tërësia e elementeve përbërëse të tyre dhe përshtypja e përgjithshme që shkaktojnë ato tek konsumatori, por duke u fokusuar më tepër në elementet dominante që mbartin edhe karakterin dallues të markave në shqyrtim. Elementet verbale * dhe ***dizenjo përkatëse janë elemente objekt i mbrojtjes ligjore për arsye se kanë karakter dallues në bazë të pikës 1/b të nenit 142 të nr. 9947, datë 07.07.2008, "Për pronësinë Industriale" i ndryshuar, dhe pikës 1.2, të kreut III të VKM Nr.1706 datë 29.12.2008 "Për Miratimin e Rregullores për Regjistrimin e Markave Tregtare dhe të Shërbimit" (i ndryshuar), sepse shërbejnë në treg për të treguar llojin, cilësinë, sasinë, qëllimin, vlerën, origjinën gjeografike ose kohën e prodhimit të mallrave apo të kryerjes së shërbimeve, ose për të treguar karakteristika të tjera të mallrave apo të shërbimeve. Si të tilla do t'i nënshtrohen analizës sonë të ngjashmërisë. Nga të gjitha aktet shkrese të administruara në seancë gjyqësore rezulton se pala e paditur ka përdorur në mënyrë pothuajse identike të njëjtat terma dhe dizenjo tregtare *** dhe ***.**

Konstatohet se të markat në konflikt kanë një element verbal identik "**", i cili rezulton në qendër të markës me përmasa dominuese, në pozicion dominues. Këto karakteristika kanë të bëjë me aspekte vizive. Eshtë e konsoliduar nga praktika në treg se përgjithësisht në rastin e markave fjalë dhe figurë, elementi fjalë luan rolin më të rëndësishëm në tërësinë e markës, për arsye të impaktit më të fuqishëm që ka ky element në procesin e memorizimit nga publiku, për vetë forcën që ka gjuha si mjeti më i plotë i komunikimit, duke qenë se fjala perceptohet prej konsumatorit nëpërmjet të parit, të lexuarit, të kuptuarit, të dëgjuarit, dhe të folurit (të përmendurit verbalisht).**

Markat duke qenë se kanë elemente verbale të njëjta, e orientojnë perceptimin e konsumatorit në të njëjtën origjinë tregtare. Pavarësisht se markat ndryshojnë njëra nga tjetra vizualisht, duhet marrë parasysh se në perceptimin e konsumatorit shqisat funksionojnë jo të ndara, por njëkohësisht, d.m.th. përshtypja e përgjithshme mbi markën tek konsumatori krijohet nga bashkëpunimi i perceptimit të krijuar njëkohësisht nëpërmjet shikimit, dëgjimit si dhe leximit të saj.

Sa më sipër, si dhe për faktin e praktikës së njohur dhe të konsoliduar në treg që pronarët e markave të mëparshme regjistrojnë variante të markave të tyre për të lançuar produkte të reja, për të rinovuar imazhin ose për motive të tjera marketingu, gjykojmë se markat krijojnë konfuzion te konsumatori i cili i ngatërron ato me njëra tjetrën, si dhe

krijon bashkelidhje midis tyre në lidhje me origjinën e tyre tregtare. Gjykata ka bërë një krahasim të gjithëanshëm të ngjashmërive vizuale, fonetike dhe konceptuale midis markës *i të palës paditëse dhe emërtimit *** dhe – ***të palës së paditur.**

Emërtimi i markës "**" dhe *** figurë dhe fjalë e shkruar me karaktere të theksuara duke ju referuar regjistrimit përbëhet nga 2 terma gjuhësor, *** dhe *** sipas dizenjosit përkatëse. Duke ju referuar analizës së mësipërme jemi përpara rastit të një konfuzioni të mundshëm të një markë identike të regjistruar nga paditësi dhe me një emërtim tregtar të përdorur nga pala e paditur nga pikpamja vizuale dhe gjuhësore pasi fjalët "****" dhe *** janë pothuajse identike. Sipas ligjit Nr.9947 "Për Pronësinë Industriale", neni 141, në rastin e përdorimit të emrit tregtar nga i padituri "****" dhe "****" jemi në kushtet e mungesës së karakterit dallues pasi konsumatori nuk do të ishte në gjendje të dallonte mallrat e ofruara në treg nën këtë markë nga ato të ofruar në treg nga shoqëria "Shoqëria ****" duke shkaktuar konfuzion në përcaktimin e origjinës tregtare të mallit.**

Duke u mbështetur në Ligjin Nr.9947 "Për Pronësinë Industriale" Neni 142 "Refuzimi ose shfuqizimi për shkaqe absolute" përdorimi i emrit tregtar nga i padituri "**" dhe ***i përfshihet në parashikimin e pikës 1, gërma a, si një markë pa karakter dallues prandaj ajo duhet shfuqizuar si e tillë. Gjithashtu duke ju referuar faktit që marka objekt shqyrtimi dhe emërtimi tregtar më i hershëm se marka objekt shqyrtimi, janë identik nga pikpamja vizuale jemi në kushte e parashikuara në nënin 143 pika 3 gërma a, të ligjit nr.9947 "Për Pronësinë Industriale" dhe prandaj duhet të shfuqizohet.**

Nga pikëpamja fonetike marka objekt kundërshtimi (pala paditëse) dhe emri tregtar (pala e paditur) janë ngjashme me njëra tjetrën sa kohë në gjuhën shqipe kemi specifikën që sikundër është e shkruar ashtu dhe lexohet në këto kushte duke i gërmëzuar të dyja rezultatit do të jetë si më poshtë

***** në këtë rast kemi 7 shkronja standarte, katër bashkëtingëllore dhe 3 zanore**

***** në këtë rast kemi 10 shkronja standarte, 6 bashkëtingëllore dhe 4 zanore**

Duke analizuar elementët e mësipërm fonetik shqiptimi i tyre është identik pasi nuk për këto terma nuk mund të ketë shqiptim apo kuptim tjetër në gjuhën shqipe. Ndonëse emri kryesor tregtar i palës së paditur është "**" duke e marrë në konsideratë bashkë me disenjon dhe mënyrën e përdorimit të markës ***, rezulton se kemi të bëjmë me të pothuajse të njëjtën markë. Për sa më sipër edhe nga pikpamja fonetike dhe grafike jemi në rrethanat e parashikuara 142 pika 1 gërma a dh 143 pika 3 gërma a marka në fjalë e përdorur nga pala e paditur duhet ndaluar duke u mbështetur në emrin tregtar dhe regjistrimin më të hershëm të palës paditëse.**

Duke iu referuar edhe analizës së mësipërme nga ana konceptuale marka "****" ofron për publikun informacion identik me atë të emërtimit tregtar të palës paditësi "**** - ****" që ka përdorur pala e paditur. Ashtu siç u argumentua edhe më sipër marka tregtare "****" dhe ***i figurë dhe fjalë, përbëhet nga elemente me karakter përshkrues pothuajse identik që lidhen me mallin sipas klasës së mbrojtur sipas Klasifikimit të Nisës. Rrjedhimisht është fjala "****" ajo që duhet të japë karakterin dallues tek publiku për të identifikuar kështu origjinën tregtare të mallit. Në anën tjetër kemi emërtimin tregtar *** dhe *** i cili përdoret nga pala e paditur në funksion të aktivitetit të tij tregtar brenda klasës së mbrojtur sipas Klasifikimit të Nisës, për të cilën është regjistruar pala paditëse. Përsëri elementi thelbësor në emrin tregtar është fjala "****" pasi nëpërmjet këtij emri publiku dallon një klasë shërbimesh nisur nga origjina e tij tregtare.

Në kushtet kur jemi konceptualisht përpara dy emërtimeve që përcjellin informacion identik tek publiku është e paevitueshme që të shkaktohet konfuzion të konsumatori i cili e ka të pamundur të dallojë mallin apo shërbimi për nga origjina e tij tregtare. Ky konflikt lind si pasojë e i përdorimit të markës "****", identike emrin tregtar më të hershëm dhe markën e regjistruar "****" nga paditësi. Në kushtet e mësipërme dhe bazuar në nenin 173, 142 pika 1 gërma a dh 143 pika 3 gërma a, të ligjit ligjit nr.9947 "Për Pronësinë Industriale" i ndryshuar, marka objekt shqyrtimi duhet ndaluar të përdoret.

Duke iu referuar certifikatave të regjistrimit pranë DPPI marka "****" është e regjistruar ndër të tjera në klasën 43 – sipas Klasifikimit të Nisës. Ashtu si rezulton më sipër shoqëria "****" ushtron aktivitet tregtar prej vitit 1996 në fushën e shërbimeve bar - restorant.

Duke u mbështetur në sa u analizua më sipër, marka tregtare "**** - ****" që përdoret nga pala e e paditur, është identike nga pikpamja e ngjashmërisë fonetike, vizuale, konceptuale me emërtimin tregtar *** që është regjistruar nga pala paditëse. Gjykata konstaton se përveç termit *** që përdorin të dy palët ndërgjyqëse, edhe termi *** është pothuajse identik e ngjashmërisë fonetike, vizuale, konceptuale me emërtimin tregtar *** që është regjistruar nga pala paditëse. Rrjedhimisht konfuzioni që shkaktohet tek konsumatori është i pamohueshëm dhe i paevitueshëm, si pasojë e lidhjes shumëplanëshe të markës së përdorur nga paditësi dhe pala e paditur.

Bazuar në nenin 141 të Ligjit Nr.9947 "Për Pronësinë Industriale", në rastin e përdorimit të emrit tregtar "****i" nga pala e paditur gjykata konstaton mungesën e karakterit dallues pasi konsumatori nuk do të ishte në gjendje të dallonte markat e ofruara në treg nga nga pala e paditur me markat e ofruara në treg nga pala paditëse duke shkaktuar konfuzion në përcaktimin e origjinës tregtare të markës.

Qëllimi i ligjit është të mbrojë markën tregtare si në një klasë apo në shumë klasa sipas Konventës së Parisit "Për mbrojtjen e Pronësisë Industriale". Është mjaftueshme që të ketë ngjashmëri në një klasë, që të çënohen interesat legjitime të subjektit tregtar. Në rastin kur ka ngjashmëri më shumë se një klasë atëherë interesat tregtare çënohen progresivisht më shumë.

Gjykata ka konstatuar se emri tregtar i palës së paditur *** dhe *** me markat *** të palës paditëse janë fjalë me dallueshmëri të ulët për shkak se rrënja dhe baza e tyre është vetë fjala ***. Mirëpo ky është një pretendim që nuk mund të jepet në mënyrë të tillë strikte gramatikore. Ngjashmëria fonetike është një ngjashmëri që nuk ka lidhje vetëm me zanoret apo bashkëtingëlloret. Por ajo ka lidhje me shumë elementë gramatikor dhe jo gramatikor. Ngjashmëria fonetike, ngjashmëria vizuale dhe ngjashmëria e dizenjës të termit con në një konfuzion të pashmangshëm për konsumatorin mesatar. Gjithsesi në cdo rast gjykata nuk bën vetëm analizë gjuhësore apo fonetike. Por Gjykata ndjek dhe zbaton frymën dhe gërmën e ligjit. Sa më të ngjashme të jenë mallrat ose shërbimet e etiketuara dhe sa më e dallueshme të jetë marka e mëparshme, aq më e madhe do të jetë dhe mundësia për ngatërrim. Në cdo rast, konfuzioni është nocion relativ por gjykata vlerëson të gjitha rrethanat si nga pikpamja fonetike, vizuale ashtu edhe nga pikpamja konceptuale që shtojnë mundësinë e konfuzionit. Në rastin konkret emri tregtar *** dhe *** i përdorur nga pala e paditur dhe markat ***, duke i parë në të gjithë rrethanat dhe natyrën e njëjtë të produktit krijojnë një konfuzion të dukshëm të konsumatori.

Duke analizuar sa më sipër gjykata konstaton se nga Çertifikata e regjistrimit datë 09.12.2015 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale rezulton se shoqëria *** është pronare e markës tregtare *** me numër regjistrimi *** datë *** për mallrat e klasës 43 të klasifikimit të Nicës: "Shërbime në fushën e restorantit, ushqime dhe pije; shërbime katering, shërbim bari, restorant, restorant me vetë-shërbim, kafeteri; snack bar dhe nga Çertifikata e regjistrimit datë *** lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale rezulton se shoqëria Shoqëria *** është pronare e markës tregtare *** me numër regjistrimi *** datë *** për mallrat e të klasës 43 të klasifikimit të Nices: "Shërbime në fushën e restorantit, ushqime dhe pije; shërbime katering, shërbim bari, restorant, restorant me vetëshërbim, kafeteri; snack bar. Sa më sipër Gjykata urdhëron palën e paditur *** person fizik të nderpresë përdorimin e fjalës dhe shenjës dhe markës "****" dhe *** në aktivitetin e saj tregtar.

Pala paditëse ka kërkuar gjatë procesit gjyqësor marrjen e masës së sigurimit të padisë në lidhje me objektin e gjykimit. Në interpretim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, në gjykime të sigurimit të padisë, gjykata vlerëson ekzistencën e dy kushteve themelore: a) ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë; dhe b) ekzistenca e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se pala e paditur ka shkelur një të drejte të ligjshme të shoqërisë *** si shoqëri që ka aplikuar dhe ka fituar pronësinë e markës regjistruar "****". Mirëpo për shkak të shumë rrethanave subjektive dhe objektive rezulton se kjo çështje gjyqësore ka një kohë relativisht të gjatë në shqyrtim gjyqësor. Kjo padi gjyqësore është regjistruar në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë më datë ***. Ndërkohë që pala e paditur ***jo vetëm vazhdon të përdorë markën "Bar ****" dhe *** por nuk

është paraqitur në asnjë senacë gjyqësore për të shprehur të drejtat e saj në lidhje me këtë process gjyqësor.

Në nenin 202 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet :

Me kërkesën e paditësit, gjykata lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë. Sigurimi i padisë lejohet kur:

padia mbështetet në prova me shkresë;

paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata,

për dëmin që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.

Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja "a" e këtij neni.

Gjykata konstaton se në këtë çështje gjyqësore ekzistojnë kushtet e emergjencës dhe mundësia potenciale për ardhjen e dëmëve të konsiderueshme për palën paditëse pasi pala e paditur po kryen veprime të vazhdueshme për mos njohjen e të drejtës së palës paditëse. Kohëzgjatja e këtij procesi gjyqësor si dhe të gjitha vendimet civile, administrative dhe penale që janë marrë në mbrojtje të markës së regjistruar nga paditësi, i krijojnë bidjen gjykatës se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit mund të bëhet i pamundur ose i vështirë në rast se nuk do të vendoset masa për sigurim padie. Sa më sipër gjykata urdhëron marrjen e masës së sigurimit për mospërdorimin e paautorizuar të markës tregtare "BAR ***" dhe *** nga pala e paditur deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Sa më sipër, gjykata krijoi bindjen se kërkesa padia e palës paditëse është e plotësisht mbështetur në ligj dhe në prova dhe si rrjedhojë e kësaj mbështetjeje, ajo duhet pranuar plotësisht.

PËR KETO ARSYE

Gjykata, mbështetur në nenin 126 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Pranimin e padisë.

Konstatimin e përdorimit të paautorizuar të markës tregtare " ***" dhe ***, e regjistruar kjo e fundit nga mbajtësi i së drejtës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave me numër regjistrimi kombëtar ***, nga shoqëria ***.

Ndalimin e përdorimit të markës tregtare "****" dhe *** në publikimin dhe reklamimin e shërbimeve nga pala e paditur.

Konstatimin e konkurrencës së pandershme nga pala e paditur.

Vendosjen e masës së sigurisë për mospërdorimin e paautorizuar të markës tregtare "**" dhe *** nga pala e paditur deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.**

Ky vendim perben titull ekzekutiv pasi te mare forme te prere si dhe eshte i ekzekutueshem nga permbarimi.

Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tirane, sot më datë 30.04.2021.

**Sekretare
Gjyqtar**

**Kludia ABAZAJ
Julian HAXHIU**